

Evropa Juglindore forcon bashkëpunimin rajonal mbi të dhënat statistikore Konferenca Rajonale në kuadër të Presidencës Shqiptare të SEECP-së *Tiranë, 23-24 tetor 2014*



Në kuader të aktiviteteve të Presidencës Shqiptare të Proçesit të Bashkëpunimit të Vendeve të Evropës Jug-Lindore (SEECP), u zhvillua në Tiranë Konferenca Rajonale mbi Statistikat Gjinore.

Konferenca kishte në fokus barazinë gjinore, duke ofruar një analizë të fenomenit në Shqipëri, përmes të dhënave statistikore të realizuara nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT).

Në Konferencë ishin të ftuar edhe drejtues e ekspertë të Instituteve të Statistikave nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore, duke krijuar një mundësi unike në nivel rajonal për të diskutuar, për të shkëmbyer informacione, përvoja dhe ekspertiza rreth kësaj teme.

Konferencën e përshëndeti edhe Drejtori i Përgjithshëm i Marrëdhënieve Dypalëshe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, z. Sokol Gjoka, i cili theksoi se: Konferenca është pjesë e aktiviteteve në kuadër të Kryesisë Shqiptare të Procesit të Bashkëpunimit të vendeve të Evropës Jug-lindore (SEECP) dhe është njëherazi, vazhdim i aktiviteteve të zhvilluara gjatë kryesisë së mëparëshme rumune të Procesit. Pasi vuri në dukje se presidenca jonë në këtë nisëm është një ndërmarrje e rëndësishme politiko-diplomatike, ai theksoi se Ministria e Jashtme do të jetë pika koordinuese e aktiviteteve që parashikohen gjatë kësaj periudhe, me synimin që Tirana të bëhet: “kryeqyteti i aktiviteteve Rajonale”, pasqyrë e prioriteteve të politikës sonë të jashtme, mbështetur në fqinjësinë e mirë dhe në rritjen e autoritetit dhe imazhit të Shqipërisë.



Në takim u publikuan dy botime nga INSTAT-i: “Femra e Meshkuj në Shqipëri-2014” dhe “Perspektiva Gjinore në Shqipëri” bazuar në rezultatet e censusit të fundit të popullsisë. Rezultatet e studimeve që japin një tabullo të plotë të gjëndjes dhe të tendencave të popullsisë shqiptare, u pasuruan më tej përmes diskutimeve dhe shkëmimit të eksperiencave nga të ftuarit prej vendeve të rajonit, të cilët vlerësuan përmbajtjen e aktivitetit dhe nivlin shkencor të punimeve të paraqitura.